

Shoqata «Pfadi»!

«Pfadin» zakonisht njeriu e takon ditëve të shtuna, në pyje, në fshatë apo në qytet. Në bazë të veshjes njihen dhe dallohen lehtë, mirëpo çka ata bëjnë për shumëkënd është e paqartë: dhezin zjarre, bëjnë tenda e edhe në të reshurat e mëdha janë në natyrë. Të gjitha këto veprimtari janë të ngushtë lidhura me nocionin «Pfadi».

Mirëpo, për Pfadin don të thotë diçka më tepër dhe atë shfryje gjer në pakufi, me moshatarët diç me ndërmarrë, pëjetime në një shoqëri dhe bashkësi të mrekullueshme.

albanisch

PFADI.

Pfadi iu dedikohet fëmijëve dhe të rinjëve që nga mosha shkollore. Është e hapur për djemë e vajza nga të gjitha vendet. Politikisht dhe konfesionalisht është neutrale. Pfadi është i ndarë në bazë të moshës në 4 grupe që u përgjigjet grupmoshave të caktuara. E egzistojnë poashtu grupe të djemve, vajzave dhe grupe të perziera, e veprimet, respektivisht aktivitetet iu përgjigjën dhe përshtatën poashtu moshës së caktuar. Në të gjitha grupet fëmijët dhe të rinjët mësojnë së pari të jetojnë së bashku, ta respektojnë njëri-tjetrin si dhe e fitojnë ndjenjën e një roli aktiv dhe me përgjegjësi, me fjalë të tjera një parapre-gaditje për jetë. Nën moton «Të rinjët udhëheqin të rinjët» qysh herët fitohet ndjenja udhëheqëse. Për udhëheqësit dhe udhëheqëset e grupeve, e gjithë kjo është një nxitje e madhe. Ata me një seriozitet dhe përgjegjësi të madhe marrin besimin që u ipet si nga fëmijët poashtu edhe nga prindërit dhe për gjithë çka bëjnë janë një shembull për fëmijët dhe të rinjët e tjerë. Këta udhëheqës të rinjë nuk janë dhe nuk e ndiejnë veten të vetmuar sepse kanë mbikqyrjen nga udhëheqësit/et më të vjetër dhe më me përvojë. Për parapërgaditjen e tyre organizohen rregullisht kurse të ndryshme.

AKTIVITETET E SIPAS GRUPMOSHËS.

Aktivitetet e Pfadit zhvillohen zakonisht në një të shtunë pasdite, ku të rinjët zakonisht së bashku me udhëheqësit e tyre të rrethit, takohen tek vendëndalja e autobusit ose tramvajit.

Kështu fëmijët dhe të rinjët së bashku me udhëheqësit e tyre përgjatë një vikendi në afërsi të rrethit rregullisht organizojnë shkuarje në kamping dhe atje kalojnë natën, e që posaqërisht është një përjetim i veçantë për fëmijët. Pos kësaj pushimet verore dhe vjeshtore i kalojnë një deri dy javë në kamping.

Grupmosha e grupit të parë të fëmijëve i kalojnë këto pushime në një Pushimore, gjersa të tjerët i kalojnë në natyrë dhe nën Tenda. Kampingu është në të shumtën e rasteve piadestali i veprimtarisë së tyre.

QËLLIMET.

Pfadi i përfshinë fëmijët dhe të rinjët e të gjitha grupmoshave në shumë pikëpamje, poashtu ndikon që këta anëtarë të jenë aktiv në veprime por të jenë dhe vetëpërgjegjës dhe vetëkritik.

Fëmijët dhe të rinjët duhet t'i njohin kërkesat e tyre emocionale dhe trupore si dhe t'i njohin mundësit dhe kufijtë e veprimit, e poashtu nuk bën që të anashkalohe marrëdhënjet ndërnjerëzore.

Në Pfadi Shoqërinë, fëmijët dhe të rinjët zbulojnë botën që i rrethon me të gjitha bukuritë dhe fshehtësitë, mësojnë poashtu se si të sillen në natyrë dhe shoqëri. Pfadi ka për qëllim në rend të parë që të rinjëve t'ju ndihmojë ta gjejnë qëllimin dhe arsyen e jetës.

HISTORIKU I SHKURTËR NË FAKTE.

Pfadi Shoqata është themeluar më 1907 nga Lordi dhe Zonja Baden Powel në Britani të Madhe. Qëllimi i tyre ishte që të rinjët me plotë kuptimin e fjalës t'i angazhojnë si dhe t'iu ndihmojnë në përjetime të përbashkëta. Llogaritet që sot të jenë rreth 25 milionë anëtarë në tërë botën. Në këtë shoqatë mbarëbotërore është e angazhuar poashtu edhe Shoqata Pfadi e Zvicrës (PBS). Me 51.200 anëtarë, është Shoqata më e madhe e të rinjëve në Zvicër. Në kuadër të shoqatës zvicerane janë nëndegët e ndara sipas Kantoneve, ku një prej tyre është edhe ai i «Pfadi Kanton Bern». Kjo shoqatë përbëhet poashtu prej reparteve të ndryshme, ku secili është përgjegjës për veprimtarinë e vetë.

SHPENZIMET.

Pagesa për pfadin kap shumë për afërisht prej 50 deri në 100 Sfr. në vitë. Kësaj i shtohen edhe shpenzimet për aktivitetet të veçanta si psh. bileta për kopshtin zoologjik, pagesën për kampe dhe paisje tjera të posaçme (këmishën e Pfadit, çantën etj.)



pfadi kanton bern
PKB

Sekretariat Pfadi Kanton Bern
Speichergasse 31
3011 Bern

Tel: 031/311 57 64
www.pfadibern.ch
sekretariat@pfadibern.ch




BIENLI/WÖLFLI. Shkalla e parë përfshin grupmoshat prej 7–11 vj.

Të shtuneve pas dite kamp ky grup i fëmijëve duke lozur së bashku njihet me ambientin. Pastaj pasojnë edhe tregimet interesante, si psh. (Pipi qorapëgjata, Libri i xhungllës, apo Magjistari), ku fëmijët praktikisht përjetojnë fantazinë e tyre. Të qenit së bashku me fëmijët e tjerë për luajtur, vallëzuar, kënduar, të gjitha këto, janë pjesë përbërse e aktivitetit të tyre gjatë një të shtuneje pasdite.

PFADI. Shkalla e dytë përfshin grupmoshat prej 11–15 vj.

Ky grup i fëmijëve i koordinon aktivitetet në mënyrë aktive ku fëmijët përjetojnë gjëra të veçanta dhe të paharrueshme. Përbrenda grupit i mundësohet secilit të ketë përgjegjësi. Aktivitetet e këtij grupi kufizohen brenda një teme: psh. Indianët, Piratët, apo rrugëtimi nëpër botë dhe kalojnë prej një veprimtarie në tjetrën, prej asaj që mund të quhet intelektuale e shoqërore në atë sportive etj. e deri te përjetimet e përbashkëta.



PIONIERS. Shkalla e tretë përfshin grupmoshat prej 15–18 vj.

Primare është ndjenja e bashkësisë, gjë e cila bazohet nga veprimet dhe aktivitetet e planifikuara. Një veçori apo tipar karakteristik i këtij grupi është se, aktivitetet nuk i kanë të parapara, repektivisht të planifikuara si në dy grupet e para por vetëm koordinohen veprimet. Programi përfshin aktivitete më të mëdha e të cilat nuk janë ngushtë të lidhura vetëm me një të shtune pasdite, por mund të jenë më të gjata.

ROVER. Shkalla e katërt përfshin grupmoshat mbi 18 vj.

Ky grup ofron mundësi të ndryshme organizimi në nëngrupe që së bashku pastaj idetë e ndryshme t'i realizojnë. Ka edhe aktivitete speciale të cilat përfshijnë edhe një angazhim social, e që mund të jenë me karakter ndërkombëtarë. Shumë anëtarë të këtij grupi janë të angazhuar edhe si udhëheqës grupi.

